



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 335 / Prot
6

Durrës, më: 04.02.2026

V E N D I M

Nr. 13, datë 04/02/ 2026

PËR

**"MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PRAKTIKËS
PROFESIONALE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR, TË
FAKULTETIT TË BIZNESIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU",
DURRËS"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; referuar shkresës së Fakultetit të Biznesit Nr. 170 Prot., datë 20.01.2026, si dhe në shkresën me Nr. 170/2 prot., datë 03.02.2026 të Drejtorisë Juridike, në mbledhjen e datës 04.02.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e e ndryshimeve në Rregulloren e Praktikës Profesionale të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, të Fakultetit të Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore, FB
 - Drejtorja e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
 - Drejtorja Juridike
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

RREGULLORE
E
PRAKTIKËS PROFESIONALE
Për Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor

website:

www.uamd.edu.al

e-mail:

fbuamd@yahoo.com

facebook: [Fakulteti i Biznesit -UAMD](#)

Instagram: [fb_uamd](#)

Durrës më, 03.10.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për programet e e ciklit të parë të studimeve, Bachelor, të ofruara nga Fakulteti i Biznesit, UAMD.

Baza ligjore e rregullores


Rregullorja e praktikave mësimore për programet e ofruara nga Fakulteti i Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" – Durrës, mbështetet në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*", si dhe në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 "*Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*"; Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

RREGULLORE MBI PRAKTIKËN PROFESIONALE PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR

NENI 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME MBI PRAKTIKAT

1. Praktika Profesionale përbën një element të rëndësishëm në kurrikulat e programeve të Ciklit të Parë të studimit.
2. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e njohurive të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik dhe profesional.
3. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara, studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione/organizata/kompani.
4. Përgjatë periudhës së realizimit të praktikës studenti duhet të përdorë dhe përfshijë njohuritë teorike të përfituara me njohuritë praktike për të synuar në këtë mënyrë aftësi profesionale drejt rrugëve të ardhshme të karrierës. Studenti që nuk realizon programin e praktikës i nënshtrohet rregullave të vendosura si për të gjithë detyrimet e tjera.
5. Studenti nuk mund të vazhdojë me detyrimet përmbyllëse pa kryer detyrimin e praktikës dhe pa u vlerësuar për të.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

NENI 2

QËLLIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE

1. Komponenti i praktikës synon t'i pajisë studentët me njohuri praktike si dhe t'u krijojë mundësi për punësim të mëtejshëm. Po ashtu krijon mundësi për:
 - a. të zgjeruar e thelluar njohuritë teorike të përfituara gjatë procesit mësimor dhe për të krijuar aftësi profesionale praktike të rëndësishme për vijimin e studimeve, apo të ushtrimit të profesionit;
 - b. t'u njohur me kompani, organizata, institucione;
 - c. të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme dhe për të startuar krijimin e një rrjeti për pozicione të mëtejshme me kohë të plotë;
 - d. të krijuar një ndikim pozitiv mbi kompaninë/organizatën/institucionin ku kryhet praktika.
2. Fakulteti i Biznesit shërben si një qendër inovative dhe sipërmarrëse, e cila monitoron tregun për të ndërtuar dhe zhvilluar më tej programe e kurrikula të reja e të përditësuara. Mbi këtë bazë, praktika duhet të konsiderohet si një periudhë ku studenti koordinon në mënyrë aktive praktikën në kompaninë/organizatën/institucionin e përzgjedhur prej tij/Departamentit me fillimin e karrierës së tij apo vijimin e studimeve në cikle të tjera studimi.

NENI 3

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR ORGANIZIMIN, NDJEKJEN DHE ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE

1. Zv.Dekani për Procesin Mësimor është përgjegjës për Ciklin e Parë të Studimeve, i cili koordinon dhe monitoron zhvillimin e praktikave mësimore për studentët e të gjitha programeve të Ciklit Bachelor (me kohë të plotë) në Fakultetin e Biznesit, UAMD.
2. Përgjegjësi i Departamentit organizon procesin e caktimit të pedagogëve përgjegjës për mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës, si dhe drejton e monitoron procesin që nga momenti i caktimit të studentëve në institucione/organizata/ kompani e deri në momentin e vlerësimit të kësaj disipline me notë.
3. Fakulteti i Biznesit dhe Zyra e Karrierës kujdeset për parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave mësimore dhe për orientimin e tyre në institucione/organizata/kompani.

NENI 4

PROÇESI I ZHVILLIMIT TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

1. Për gjetjen e institucionit/organizatës/kompanisë ku do të zhvillohet praktika, studenti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT


- bazohet te marrëveshjet e bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit, UAMD-së. Gjithashtu përdor rrjetet individuale (njohje, interes apo sugjerime), si dhe databazën e UAMD-së.
2. Para fillimit të semestrit të dytë të procesit mësimor, studenti Praktikant duhet të plotësojë kërkesën për autorizim, për kryerjen e Praktikës pranë institucionit/organizatës/kompanisë X (të cilin e tërheq nga sekretaria mësimore).
 3. Shpërndarja e studentëve në kompani/institucione/organizata duhet të kryhet në bazë të shkallës së përputhshmërisë së preferencës së studentit me programin e studimit. Kjo shpërndarje miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili vendos edhe pedagogun që do të udhëheqë përgjatë praktikës studentin.
 4. Lista përfundimtare e shpërndarjes së studentëve sipas kompanive / institucioneve / organizatave së bashku me pedagogët mbikëqyrës afishohet pranë departamenteve përkatëse.
 5. Grupi mësimorë i praktikës, që do të udhëheqë pedagogu mbikëqyrës, duhet të jetë jo më i madh se 20 studentë.
 6. Pedagogu udhëheqës duhet të ushtrojë kontrolle periodike pranë institucioneve/kompanive që studenti po zhvillon praktikën.
 7. Kohezgjatja e Praktikës Profesionale shtrihet në një periudhë 15 javë dhe organizohet në 150 orë gjithsej, nga të cilat 75 orë zhvillohen në praktike jashte auditorit pranë bizneseve /institucioneve dhe 75 orë studim individual.
 8. Në fund të praktikës dhe përpara mbrojtjes përfundimtare të praktikës, studenti praktikant ka për detyrë të dorëzojë pranë departamentit:
 - a. formularin e vlerësimit të studentit nga pedagogu mbikëqyrës (Aneksi 1);¹
 - b. formularin e vlerësimit (Vertetim Praktike) të studentit nga mbikëqyrësi në kompani/institucion/organizatë (Aneksi 2);
 - c. raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës (Aneksi 3).

NENI 5

DETYRIMET E STUDENTIT GJATË PRAKTIKËS PROFESIONALE

1. Studenti i Ciklit të Parë të studimeve duhet të konsiderojë praktikën si një proces të pa shkëputur nga procesi i kërkimit në funksion të realizimit të Tezës së Diplomës apo detyrimeve të tjera përmbyllëse.
2. Në kompaninë e përzgjedhur studenti përgjatë periudhës së praktikës synon të krijojë kontakte dhe rrjete komunikimi me përfaqësues të niveleve të ndryshme manaxheriale, të burimeve njerëzore, etj. Studenti duhet të marrë pjesë aktive në funksione të ndryshme brenda kompanisë të përcaktuara edhe nga Mbikqyrësi, si dhe të ofrojë mbështetje dhe

¹ Aneksi 1, Aneksi 2, Aneksi 3, bashkëngjitur kësaj Rregullore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

rolin e tij modest në kompani/institucion.

3. Detyrimet e studentit përgjatë periudhës së praktikës janë:
 - a. të ndjekë praktikën profesionale sipas parashikimit në planin mësimor;
 - b. të respektojë rregulloren dhe kushtet e punës të kompanisë/organizatës/institucionit përkatës;
 - c. të jetë i gatshëm të kryejë detyrat e ngarkuara;
 - d. të plotësojë dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e praktikës sipas parashikimeve të kësaj rregullore;
 - e. të hartojë raportin përfundimtar të praktikës të cilin do ta referojë dhe do të vlerësohet përpara Komisionit të Vlerësimit.

NENI 6

VLERËSIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE

1. Përgjatë kohës së kryerjes së praktikës studenti është nën udhëheqjen dhe mbikqyrjen e një pedagogu të fushës së tij (anëtar i Departamentit që mbulon programin përkatës), i cili në përfundim të praktikës dhe përpara procesit të mbrojtjes para Komisionit të Vlerësimit, jep aprovimin dhe vlerësimin e tij nëpërmjet plotësimit të një formulari. Në këtë formular jepet një vlerësim i përgjithshëm i ecuresë së praktikës.
2. Me propozim të Përgjegjësit të Departamentit dhe me miratim të zv.Dekanit Mësimor për Ciklin e Parë të Studimeve njoftohet kalendari i mbrojtjes së praktikave mësimore dhe përbërja e komisioneve vlerësuese.
3. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre pedagogë të departamentit përkatës (ku njëri prej tyre është kryetari dhe dy të tjerët anëtarë).
4. Praktika vlerësohet me notë ashtu sikurse të gjitha disiplinat e tjera të ciklit të parë të studimeve.
5. Elementet përbërëse të vlerësimit janë:
 - a) Vlerësimi i ecuresë së studentit në procesin e orëve praktike nga pedagogu udhëheqës;
 - b) Mbrojtja e praktikës profesionale së bashku me dokumentacionin përkatës.
 - c) Procesverbali përfundimtar i vlerësimit të praktikës profesionale nga Komisioni i Vlerësimit firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

NENI 7

PËRJASHTIME NGA RREGULLI

1. Mbrojtja e praktikës jashtë afatit të përcaktuar

Studenti që nuk realizon procesin e mbrojtjes së praktikës brenda afatit normal të përcaktuar, mund





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

ta realizojë mbrojtjen e saj në datën e radhës për mbrojtje.

2. Praktika mësimore për studentët në marrëdhënie pune

1. Nëse një student punon me kohë të plotë ose të pjesshme gjatë periudhës që ka detyrim të kryejë praktikën mësimore, atij mund t'i konsiderohet kjo punë si plotësim i detyrimit për orët praktike jashtë auditorit nëse plotësohen të treja kushtet e mëposhtme:
 - a. puna që ai/ajo kryen është në të njëjtën fushë me programin e studimit;
 - b. studenti sjell një vërtetim nga punëdhënësi i cili pohon se studenti punon në këtë institucion/ organizatë/kompani, shoqëruar edhe me një përshkrim të punës që kryen
 - c. studenti paraqet një kërkesë pranë Përgjegjësit të Departamentit për njohje të punës së kryer si praktikë mësimore.
2. Studentët të cilët kanë përfutur nga programi i shkëmbimit Erasmus+ dhe gjatë kësaj kohe, kanë kryer në Universitetin pritës një program të praktikës, mund të kërkojnë njohjen e praktikës pranë departamenteve përkatës duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim.

NENI 8 DOKUMENTACIONI

Formularët përkatës që gjenden bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë :

1. Formular Vlerësimi i Pedagogut Udhëheqës (Aneksi 1).
2. Vërtetimi i lëshuar nga Biznesi/Institucioni ku është kryer praktika mësimore (Aneksi 2).
3. Raporti i Praktikës Mësimore (Aneksi 3).
4. Formular ndjekjeje të orëve të lektorit mbikëqyrës gjatë praktikës profesionale (Aneksi 4)

Këto dokumenta janë formate orientuese të cilat mund ti nënshtrohen modifikimeve nga ana e departamenteve sipas specifikimeve të tyre përkatëse.

NENI 9

Kjo Rregullore hyn në fuqi me *Vendimin e Dekanatit Nr. 23 Datë 03.10.2025*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Aneksi 1

Formular vlerësimi i pedagogut udhëheqës për Studentin Praktikant¹

Cikli i Parë i Studimeve, Bachelor në _____

Emri, Mbiemri i Studentit: _____

Institucioni/Kompania/Organizata: _____

Emri, Mbiemri i Pedagogut Udhëheqës: _____

Pozicioni pranë Institucionit/kompanisë/organizatës: _____

Fusha e vlerësimit	PO	JO
1. Përkon pozicioni i studentit në vendin e praktikës me programin e ndjekur të studimit?		
2. Ka raportuar studentit në mënyrë periodike mbi mbarëvajtjen e praktikës mësimore?		
3. Ka frekuentuar në masën e kërkuar seancat në auditor?		
4. Ka mbajtur mbikëqyrësi në kompani komunikime të vazhdueshme mbi mbarëvajtjen e praktikës së studentit?		
5. Është hartuar raporti i praktikës mësimore konform rregullave dhe udhëzimeve?		

Keni komente të tjera mbi mbarëvajtjen e praktikës mësimore të studentit?

Mbi bazën e raportimeve periodike të studentit dhe mbikëqyrësit, si dhe mbi bazën e raportit të praktikës mësimore, si do e vlerësonit performancën e studentit praktikant?

☐ Studenti e përfundoi me sukses periudhën e praktikës mësimore.

• Studenti e përfundoi periudhën e praktikës mësimore, por kam rezerva për mbarëvajtjen e saj.

• Studenti nuk ka respektuar rregullat e zhvillimit të praktikës mësimore.

Emri Mbiemri i pedagogut udhëheqës

Durrës,

(Data, vendi)

(Firma)

¹ Ky formular plotësohet pas përfundimit të praktikës nga PEDAGOGU UDHËHEQËS. Formulari dorëzohet i mbyllur në zarf komisionit të vlerësimit të praktikave mësimore. Mbi zarf shënohet: Emër, Mbiemër i studentit dhe numri i grupit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

_____ nësimor ku bën pjesë.

Aneksi 2

Emri dhe logoja e institucionit
Adresa

Nr. _____ Prot.

Durrës, më / /

Lënda: Vërtetim

Drejtuar: Fakultetit të Biznesit

Departamentit të _____

Me anë të këtij vërtetimi konfirmojmë se Z. _____ student/e në ciklin e parë të studimeve, Bachelor në _____, gjatë periudhës _____ deri më _____, ka kryer praktikën profesionale në sektorin e _____.

Këtë praktikë e vlerësoj të sukseshme / jo të sukseshme.


Objektivat e kësaj praktike konsistuan në:

Në përfundim vlen të theksoj se Z. _____, tregoi impenjim, kapacitet dhe cilësi të plotë gjatë zhvillimit të praktikës. Përvetësoi në kohë dhe mënyrë cilësore zbatimin e teorive të _____.

Në rolin e supervizorit vlerësoj dhe e konsideroj të sukseshme/jo të sukseshme performancën e tij/saj.

Titullari i Institucionit / kompanisë

(Emer / mbiemer / Firme/ Vule)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Aneksi 3

RAPORTI I PRAKTIKËS MËSIMORE

Të dhënat e përgjithshme

Emri: _____

Institucioni i kryerjes së praktikës: _____

Kohëzgjatja e praktikës: _____

Emri i Udhëheqësit mbikqyrës: _____

Durrës, më ____ . ____ .20 ____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

I. Hyrje

II. Përshkrimi i institucionit

- ☐ Misioni dhe Objektivat
- ☐ Vizioni
- ☐ Struktura dhe funksionet e institucionit
- ☐ Misioni dhe Objektivat e departamentit
- ☐ Struktura dhe funksionet e departamentit
- ☐ Veprimtari kryesore e institucionit gjatë perjudhës së praktikës


III. Përshkrimi i veprimtarisë së kryer

- ☐ Lloji i veprimtarisë së kryer
- ☐ Karakteristikat e punës që kryet
- ☐ Plotësimi i objektivave tuaja
- ☐ Përvoja që fituat
- ☐ Ndikimi në zhvillimin e profesionit
- ☐ Lidhja midis praktikës dhe interesit tuaj studimor
- ☐ Përfitimi nga praktika
- ☐ Sfidat dhe problemet që ndeshët

IV. Përfundimet e nxjerra nga praktika:

Student Praktikant/e:

Udhëheqësi mbikqyrës:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

(Aneksi 4)

Durrës, më ____/____/202__

FORMULAR NDJEKJEJE TË ORËVE TË LEKTORIT MBIKËQYRËS
GJATË PRAKTIKËS PROFESIONALE

Të dhëna të përgjithshme

Emri, Mbiemri i Pedagogut Mbikëqyrës	
Departamenti	
Programi i Studimit	
Viti akademik	
Periudha e praktikës	
Numri i studentëve të mbikëqyrur	

Tabela e ndjekjes së orëve të mbikëqyrjes

Nr.i javeve	Data (nga-deri)	Aktiviteti i zhvilluar	Emrat e studentëve të përfshirë	Orët e angazhimit	Nënshkrimi i pedagogut
1					

-15 rreshta perkojnë me 15 jave të zhvillimit të praktikës mesimore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Përmbledhje e aktivitetit

Numri total i orëve të realizuara nga lektori: _____

Numri i kontakteve individuale/student: _____

Komente të përgjithshme mbi ecurinë e praktikës:

.....

Vlerësim i përgjithshëm nga pedagogu.

Vlerësimi për studentin 1.

Vlerësim për studentin 2.....

- ☐ Studentët janë ndjekur rregullisht gjatë praktikës.
- ☐ Janë kryer vizita periodike në kompani/institucione.
- ☐ Studentët kanë raportuar mbi ecurinë sipas kërkesave të rregullores.
- ☐ Janë identifikuar sfida/problematika (shëno poshtë nëse ka):

.....

Pozicioni	Emër Mbiemër	Data	Firma
Pedagogu mbikëqyrës			
Përgjegjësi i Departamentit			





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

--	--	--	--

Udhëzime

- Formulari plotësohet nga pedagogu përgjatë gjithë periudhës së praktikës (15 javë).
- Dorëzohet në fund të praktikës pranë Departamentit bashkë me raportin e praktikës përmblledhës të studentëve.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr. 506/prot.
4

Durrës, më 03 / 10 / 2025

Lënda: Relacion mbi ndryshimet e Rregullores së Praktikës Profesionale për Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor, në Fakultetin e Biznesit.

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" nenit 35 dhe 38 pika "dh"; VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 "Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë"; të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Vendimit të Rektoratit Nr. 9 datë 16.06.2025, pika 3, si dhe Vendimit të Dekanatit të Fakultetit të Biznesit Nr. 15, datë 17.06.2025, pika 3; si dhe Urdherit të Dekanit Nr. 25, datë 20.06.2025 për "Ngritjen e grupit të punës për rishikimin e rregullores së praktikës profesionale për ciklin e parë të studimeve bachelor dhe rregulloren e praktikës profesionale dhe mikrotezës për ciklin e dytë të studimeve master i shkencave dhe profesional, të fakultetit të biznesit, UAMD", në rregulloren e re të ndryshuar të Praktikës Mësimore për Ciklin e Parë të studimeve Bachelor, janë reflektuar ndryshimet si më poshtë vijon:

- Në Nenin 4 "Proçesi i zhvillimit të praktikës profesionale" shtohet një pikë pas pikës 4;

Pika 5, "Grupi mësimorë i praktikës, që do të udhëheqë pedagogu mbikqyrës, duhet të jetë jo më madh se 20 studentë."

Pika 6: Pedagogu udhëheqës duhet të ushtrojë kontrolle periodike pranë institucioneve/kompanive që studenti po zhvillon praktikën.


Pika 6: Kohezgjatja e Praktikës Profesionale shtrihet në një periudhë 4- 15 javë dhe organizohet : 150 orë gjithsej, nga të cilat 75 orë zhvillohen në auditor sipas syllabusit të miratuar në Departament përkatës dhe 75 orë pranë bizneseve /institucioneve.

Bëhet:

Pika 7: Kohezgjatja e Praktikës Profesionale shtrihet në një periudhë 15 javë dhe organizohet në 150 orë gjithsej, nga të cilat 75 orë zhvillohen në praktike jashte auditorit pranë bizneseve /institucioneve dhe 75 orë studim individual.

Rrjedhimisht: Pika 5 bëhet pika 6, pika 6 bëhet pika 7 dhe pika 7 bëhet pika 8.

- Në Nenin 8 "Dokumentacioni", shtohet pika 4,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
DEKANI

Pika 4: Formular ndjekjeje të orëve të lektorit mbikqyrës gjatë praktikës profesionale (Aneksi 4).

Ndryshimet e lartpërmendura në rregullore, kanë për qëllim përmirësimin e funksionimit praktikës mësimore për studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor.

Përpiloi: Kryetari i grupit të punës
Dr. Silvana Gashi